



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 535 Prot.

Roskovec, më 29.01 2020

VENDIM

NR 5, DATË 24.01.2020

“PËR NDRYSHIM TË BUXHETIT 2020 NGA ZBATIMI I PROJEKTIT: “FORCIMI I MEKANIZMIT TË KORDINUAR TË REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË ROSKOVEC” ME FINANCIM TË UNDP-së”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“,neni 24 pika 1 dhe neni 54 pika dh. të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 20 pika 1,të udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”,ligjit Nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrdhëniet familjare”(i ndryshuar) neni 5 pika ë,VKM Nr.334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit”,të materialeve të sjella nga Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale,Koordinimit me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare,dhe kontratës së lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe UNDP,Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI:

- Miratimin e fondit prej **1,423,000 lekë** për projektin “**Forcimi i mekanizmit të kordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Roskovec**”,i financuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP),në vlerën 788.000 lekë dhe kontributi i Bashkisë Roskovec në vlerën 635,000 lekë (kontribut në natyrë).
 - Shtohet plani I të ardhurave 2020 zëri “Grante nga ndihma ndërkombëtare” me 788.000 lekë.
 - Shtohen plani I shpenzimeve nga fondi I financimit nga UNDP sipas materjalit të bashkëlidhur i detajuar si më poshtë vijon :

Shtohet : Gr.00 Tit.10430 Kap.06 Art.602 788,000 lekë
- Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale,Koordinimit me BE-në dhe Shërbimeve Komunitare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

